



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2026

**VENDIM**

**Nr. 227, datë 23.04.2026**

**PËR**

**PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM ME  
PËLQIM PËR GJYQTARIN ZNJ. GENTIANA XHELILI**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 46, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin të tij nr. 481, datë 31.07.2024, “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të gjyqtarit znj. Gentiana Xhelilli”, vendimin nr. 589, datë 09.09.2025 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm me pëlqim të znj. Gentiana Xhelili në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, në kushtet kur verifikohet që gjyqtari i transferuar me pëlqim, të jetë transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Përfundimin para afatit të transferimit të përkohshëm me pëlqim, për gjyqtarin znj. Gentiana Xhelili.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 23.04.2026.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit znj. Gentiana Xhelili sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**